

**Prof. Sazan GURI**

## **PLISI I KOSOVARIT & TAKIJA E MYZEQARIT**

### **OGURËT E BARDHË TË NJERËZIMIT**



Ky plis i bardh simbolizon etnitetin pellazg, traditën, njohuritë mbi perpunimin e metaleve.



# PLISI I KOSOVARIT & TAKIJA E MYZEQARIT - OGURËT E BARDHË TË NJERËZIMIT

## 1. ETIMOLOGJIA DHE KUPTIMI I FJALËS 'PLIS'

Fjala plis është e njëjtë me atë latine pile-us, e cila jo rastësisht ka të njëjtën rrënjë me fjalën "greke". (sigurisht atë të lashtë). Por, asnjëra fjalë prej tyre nuk është aq e thjeshtë apo njërrökshe sa ajo shqipe. Por, nëse duam të gjejmë etimologjinë e kësaj fjale, është pikërisht gjuha shqipe që shpëton fjalët greke, latine deri edhe atë angleze që kësaj fjale i thonë pile-pirg.



**Fig. – 1** Pamje e plisit apo takies së bardhë, e lashtë si baba Tomorri, mjet identifikues i racës


shqiptare.

Sepse, vetë plisi, ashtu është si diçka e ngritur, për arsyen e formës se ngjashme me një pirg. E veçanta është se shqipja ruan thelbin antik të të folurit dhe ne nuk kemi nevojë të kërkojmë "shqipen e lashtë". Ajo është e pranishme në çdo fjalë, në çdo gërmë, në çdo simbol, në çdo diftong, në çdo klaster të "latinishtes" dhe "greqishtes së vjetër". Jo vetëm që termi plis simbolizon diçka të ngritur, por njëherësh ajo don të thotë se ky material është prej leshi, ndaj edhe shqiptarët e quajnë qeleshe ose P-LIS~pe-lies~pi (prej) leshi (qeleshe).

**Fig. - 2** Ja vetëm disa nga artifaktet që dëshmojnë vazhdimësinë e Plisit (qeleshes), nga pellazgët deri më sot, vetëm tek shqiptarët!

Një kallëzim popullor pohon se edhe pontifiku, papa në

Romë, mban plisin e bardhë të shqiptarëve, përkatësisht të ilirëve. Me të vërtetë dhe ca klerikë të tjerë katolikë, varësisht nga rangu i tyre, mbajnë kësula, të shumtën të bardha me trajtë



gjysmësferike, të ngjashme me plisin shqiptar. Nuk mund të thuhet se ky besim popullor është i vërtetë, por për krijimin e këtij kallëzimi ka bazë historike.

## 2. PLISI APO TAKIJA E BARDHË NDËR SHQIPTARË - SIMBOL MIJËVJEÇARË

Shqiptarët, si ata të veriut dhe të jugut kanë mbajtur gjithmonë qeleshe. Në bazë të shumë materialeve të lexuara e të studiuara, mendohet se bardhësia e plisit mbi lartësinë e trupit, pra në kokë, përkon me racën dhe identitetin shqiptar. Kësulatat që i përdorin shqiptarët janë të kohës së lashtë iliro-pellazge. Qeleshja e bardhë, fustanella, tirqit, mintani me gajtana të zezë, apo xhubleta shqiptare (si veshja më e vjetër e botës), e mbetur ende gjallë, janë origjinale dhe tipikisht shqiptare. Sepse, asnjë popull në botë nuk i ka përdorur më herët se shqiptarët, dhe këto kanë ngelur në traditë pa patur asnjë shkëputje “tektonike”. Si Plisi i Kosovarit, edhe Takija e Myzeqarit simbolizojnë shpirtin e këtij populli në mijëvjeçarë.



Ky plis i bardh simbolizon etnitetin pellazg, traditën, njohuritë mbi perpunimin e metaleve.

**Fig. – 3** Pamje të farkëtarëve

pellazg qysh 2000-3000 vjet parakrishtit, që për veshje të përditshme e të punës kishin dhe takijen apo plisin.

## 3. PLISI, TAKIJA DHE LIDHJA E TYRE ME VEZËN

Ato së bashku, por edhe veç e veç, si tip kësule mbi kokë simbolizojnë gjysmën e vezës kozmike, nga e cila "vezë", Zoti krijoi çdo gjë, krijoi jetën.

<http://www.facebook.com/photo.php?pid=66198&l=db24150db1&id=100001133356751>.

Vetë takija ose plisi në kokën e mashkullit ka edhe një kuptim tjetër, madje filozofik. Ajo i ngjan dhe simbolizon:

*mitrën e femrës, ku të lashtët e njihnin shumë mirë këtë funksion, si baza e krijimit të jetës, dhe për ta shenjtëruar e përjetësuar, duke e mbajtur në kokë si kësulë pikërisht meshkujt.*

Kësisoj, Plisi/qeleshja është simbol i burrit, dhe ai nuk e





mban se është ftohtë apo ngrohtë, e as për bukuri apo me mbulu rënien e flokëve, por e mban dhe e ruan pikërisht për magjinë e mësipërme. Sepse, plisat lidhen me vezën dhe pikërisht me të kundërtën e saj. Pse meshkujt mbajnë, më saktë mbanin plisa, e femrat shami?

**Fig. – 4** *Një ndër gjetjet e shumta në trevën pellazgjike, ku godet simboli me kësulë i riprodhimit njerëzor, në respekt ndoshta të teorisë së kryqëzimit ndërplanetar në mijëvjeçarin e gjashtë para krishtit, për shkak të një hopi që ndodhi në trurin e njeriut.*

Kujtojmë se në antikitet, ylli me 6-cepa, i cili gabimisht njihet si ylli i Davidit, simbolizonte unitetin dhe harmoninë midis burrit dhe gruas, si dhe në vizatim shpreh organin gjenital të burrit të bashkuar me atë të gruas. Dhe dihet se pa këtë bashkim biologjik organesh (përgjashtuar kohën e sotme) nuk prodhohet jetë. Pra, burri duke mbajtur një kokore në formën e mitrës, kishte thellë në mendje magjinë e vazhdimësisë së jetës. Praktika tregon, se vetëm populli shqiptar, si ai i Myzeqesë, i Labërisë apo i Dardanisë, e ruajti këtë vlerë të identitetit të vet dhe kombëtar, kur shumë kombe të tjerë e ndërruan me qylafin turk.

Plisi është simboli më i vjetër falik, dhe nga ai vjen edhe përkrenarja. P.sh. Athina mbante përkrenare (simbol falik), sepse ishte “burrneshë”. Po ashtu *plis* kanë mbajtur edhe burrneshat, si Shote Galica. Frigjet (fis pellazg) shkuan dhe i bënë edhe “kokën”. Vetë Papa i Romës sesi e ka gjetur atë plis origjinal me tonin! Më vonë duhet të jetë përdorur edhe si simbol tipik fetar/mbretëror, pastaj luftarak d.m.th vetëm për burrat.

**Fig. – 5** *Perëndesha Athinë me takijen ose plisin në kokë. Në figurën e parë shohim ulur Zeusin apo Jupiterin, mbi kokë u shndrit figura e Pallas Athenës, ku përballë është mjeshtri Hefaisti – Vullcan. Është interesante, pse athena quhet me emrin Pallas Athena dhe nuk quhet Achay-Danay grek Athena, por Pallas Athena. Dhe çka paraqet figura e Hefaistit dhe pse me plis të bardhë. Pra, kush na qenkan plisat e bardhë, përpos pellazgëve-yllirëve. Këto janë dëshmi me shumë pikëpyetje.*



#### 4. PLISI E TAKIJA E BARDHË - SIMBOLIKA E VEÇANTË E SHQIPTARËVE


Bardhësia e plisit në kokë përkon me racën dhe identitetin shqiptar. Albanët, si fis i vjetër Ilir në pjesën qendrore të Shqipërisë së sotme, nga ku e morën emrin Albanians, për të cilën ka kuptim edhe morfema e parë e saj, sepse Al -

përdoret në të gjitha gjuhët indo-evropiane si diçka: E Bardhë; E Lartë; E Madhërishme.

**Fig. – 6** Plis mbi kokën e një pellazgu, qysh nga kohët antike, çka tregon vazhdimësinë e kulturës së veshjes nga popujt ilir te ata të sotëm shqiptar.

Fjalë të tjera që rrjedhin nga kjo bazë ‘Al-e Bardhë’ janë Albidoja=bardhësi-a; në Astronomi: është pjesa e dritës rënëse – vrushkulli i bardhë; Albin = albus = i bardhë, njeri apo kafshë me veti të bardha – albniste; Albinizëm = bardhësi, në mjekësi: mungesë e plotë e lëngut të pigmentit në lëkurë e në anekse të saj – shenja e bardhë e lindjes në lëkurë;<sup>1</sup>

## 5. PLISI I LIRISË/ILIRISË,<sup>2</sup>



<sup>1</sup> Albit = bardhor, në mineralogji – feldspat i bardhë; Album = bardhësi, fletore e posaçme me fletë shumë të bardha, për fotografi; Albumina = e bardha e vesë (voes); Albuminometri = në kimi, lëngu organik në të bardhë të vesë (voes) – aparat, për matjen e të zbardhurit të urinës; Albuminurina = bardhësia në serum in e gjakut e urinës, zbardhimi i urinës; Alpet, Al-E lartë dhe me bardhësi, Allah, Al-I lartë; I bardhë (i pastër) dhe i Madhërishëm. Diftongu – AL difton një lartësi të bardhë, bardhësi e lartë, shprehje e madhërishme bardhësie, për të ardhë deri tek kuptimi i dritës – bardh – kuptimi i së cilës, bardhësie të lartë, vien nga ama, ëma krijuesja e bardhësisë – dritës. Diftongu – AL difton si ngritje të lartë deri tek kuptimi i dritës, bardhësisë, e deri tek krijuesi nga drita – zjarri – në kuptimin e gjithësisë. me këtë diftong ndërtohen fjalët aq të lashta të shqipes si mal, mali, malet, malor, malok, Malcia (Malësia), malësori, malësorja, malësorët, etj. Diftongun AL e kemi po ashtu në fjalën shqipe – PAL – p\* < al (krhs), pale, paleo (zoiku), në shqipen e vjetër ka kuptimin e domethënies së lashtësisë, apo kur dikush pyet – Pale, na thuaj diçka? Apo kur çuditet njeriu për diçka – Pale pale! Si shprehje e pakënaqësisë apo edhe e kënaqësisë, kur ndëgjon diçka të bukur, të mënçur. Diftongu – AL formoi antroponome, toponome, etnonome, PIE – që mendoj se është më i lashtë sesa diftongu – AR – për të ardhë tek rrokjet e përafërta – ALB – ARB – respektivisht tek etnonomi – alban – arban – (albën – arbën) – Albania – Arbania – Arbëria, deri tek etnonomet – arbanas, arbër, arbëresh, arvanit-as, etj. Përkundër të gjitha studimeve të derisotme të linguistëve: G. Majeri, A. Majeri, N. Jokli, E. Giordano, P. Skoku, M. Pavloviqi, V. Dorsa, T. Trajanoski, P. Ilievski, J.B. Hofmani, A. Walde, H. Pedersen, A. Duccellieri, A. Vukçevići, A.V. Desnickaja, M. Shufllaji, C. Truhelka, e deri tek linguistët shqiptarë – S. Frashëri, E. Çabeji, Sh. Demiraj, A. Xhuvani, I. Ajeti, A. Buda, Z. Shkodra, R. Ismaili, S. Anamali, Dh. Shuteriqi, E. Sejda, etj., të cilët dhanë kontributet e tyre në etimologjinë e emrave – alban – arbën – si përfundim i derisotëm shkencor linguistik – “mbetet çështje e hapur dhe se nuk ekziston një mendim i përbashkët” definitiv se këto dy fjalë – alban – arbër – janë me etimologji illire-shqipe, por Çabeji e Pedersen, ngulin këmbë se këto fjalë janë të huaja (!) duke u nisur nga rrënjët – alb – arb. A duhet të mbetet kjo ende çështje e hapur, e deri kur? Mjafton ta marrësh vetëm studimin e njerit prej këtyre studjuesve dhe të gjithë i ke aty! Tani, shtrohet pyetja: cili prej tingujve të të dy rënjeve L (ALB) – R (ARB) do të ketë ekzistuar më përpara në rrënjën e vet L në alb – apo R në arb, për ta djtur se cila nga këto rrënjë është më e lashtë?

<sup>2</sup> Kastriot MELYSI, Shqipja dhe e verteta biblike, Faqe 396

Nga vetë veshjet shqiptare kupton se është mjaft interesante të studiosh thellë traditën tonë, p.sh. nusja, kur hyn së pari herë në shtëpinë e burrit të saj, i duhet të ulet në një *Plis* të kthyer mbrapsht dhe të vendosë një Plis tjetër në kokë (e njëjtë si në figurën e paraqitur më sipër). (fig. 79)

**Fig. - 7** *Plisi i lirisë/Ilirisë, Kastriot MELYSHI, Shqipja dhe e verteta biblike, Fq. 396*

Ky rit ka ose merr kuptimin, sikur fara që doli nga veza kozmike dhe solli jetën, ashtu edhe nusja "del" nga veza dhe sjell jetën në atë shtëpi. Madje, e tërë veshja kombëtare e popullit shqiptar paraqet atë besim monoteist të njeriut parak, që ti i dashur akademik quhe parak european apo parak shqiptar apo pellazg, çka simbolizon Perëndinë/Krijuesin e plotfuqishëm. Si për shembull, mëngët e Gunës që nuk vishen, por përthakohen ose lidhen pas shpinës simbolizojnë krahët/flatrat e hyjnisë. Sepse besimi i vjetër ose më mirë të themi ai parak, nga i cili kopjuan popujt e tjerë, e sidomos popujt semit, thotë që kur Krijuesi krijoi jetën nga veza kozmike/veza e botrave, ai paraqitej me krah/flatra. Këtë lloj teorie të krijimit e thotë edhe Bibla në mënyrë indirekte në Gjenezë apo Genesis.

**Fig. - 8** *Kopje e një figure të Zeusit pellazgjik, si zakonisht, me plis e me shqiponjë pranë. Rastësi që ky mbret apo perëndi e pellazgëve mban këto simbole si vetë populli i tij apo e kundërta që është po aq e vërtetë. A gjendet një komb tjetër që të ketë këto simbole si perëndia e vet.?!*

Ilirët kanë përdorur disa lloje kësulash (kapelash-kapuçesh-qeleshe-plisa) të ngjashme me njëra-tjetrën. Shikoni të dashur lexues se çdo emërtim i saj që mbahet në kokë ka kuptim në shqip, ku termi kapela ose kapuç rrjedh nga rrënja bazë kap-kaptinë apo kokë. si p.sh chapeleao në frëngjisht shpjegohet me anë të shqipes, sepse rrënja bazë e saj është 'chapo' kap – kokë shq., sepse ata kokës i thonë ndryshe.

**Fig. – 9** *L.Reolfsema, v. 1830<sup>3</sup>, Kapedan shqiptar, ku lehtësisht i kapet brezi i mesit, plisi, shalli apo peshqiri, xhamadani dhe kilotat e leshta, që të gjitha tipikisht shqiptare.*



<sup>3</sup> C. Rogier, Vizatim i vitit 1914. Brown University, Providence, USA,

Dardanët kanë përdorur kapuçin e rrumbullakët që e përdorin sot kosovarët, tipikisht i quajtur plisi dardan apo ai kosovar, sot, të cilët janë vazhduesit direkt të dardanëve qysh nga Dardania e hershme deri te ajo e mëvonshme, çka përmbliidhte trevën nga Nishi (Naisus) e deri te Bylazora (Velësi), Astipi (Shtibi), Shkupi (Skupi), Tetova (Oaeneum), Gostivari (Draudakum). Mandej, nga mali Bukovik në jug të Gostivarit e deri te Ohri, Struga, Dibra e deri te Mavrova, kanë jetuar Penestët me kryeqytet Uscana (Kërçova) dhe ky fis ilir, kanë mbajtur një kapele disi pak më ndryshe, pak si më e rrafshët, që në kohën e Skënderbeut është quajtur kësulë dibrane, sepse e ka përdorur e gjith' krahina e Dibrës. Ndërkohë që Shqipëria e Veriut mban kapuç të rrafshët, por është akoma më i shkurtër se ai dibran. Ndërsa, Shqipëria e jugut mban qeleshe të rrumbullakët, por shumë më e gjatë se ajo dardane (shiko 10), që ndryshe quhet kapuçi i Labërisë. Plisi në variantin e labërisë, quhet qeleshe dhe zakonisht ka një "antenë" të vogël në majë, ashtu si Kadmi Ilir në këtë artifakt me shumë rëndësi.

**Fig. - 10** Kjo vazo (ku shihet Kadmi Ilir me plis) ruhet në muzeun e Luvrit – Paris. Sigurisht që kemi parë edhe Kadëm grek, por pa plis.

Kadmi e vret gjarpërin me gur dhe mbjell njerëz nga "dhëmbët". Dheukalioni dhe Pyhrra hedhin plisa. Këtu, pikërisht ndeshemi me simbolikën e plisit me vezën, me pjellorinë, e deri tek veza kozmike që krijoi jetën dhe njerëzit. Në të dy rastet na ngatërrohen nëpër këmbë Ares/Marsi. Pyrra/HysPyrride/Epir do të thotë yll i mbrëmjes/errësirës.

## 6. PLISI E TAKIJA MYZEQARE - TRADITË MIJËRAVJEÇARE

Le të marrim një veshje tipike të shqiptarit toskë apo myzeqar, siç është Takija e myzeqarit, e cila mund të krahasohet me atë që mbante Zeusi në kokë, qysh 10,000 vjet para krishtit, por atë e ka mbajtur edhe Odhiseja, aq





sa në mbarë monedhat e Itakës, Odhiseja pasqyrohet gjithmonë i zbukuruar me qeleshen pellazgo- arbërore (head, Garbner), krejtësisht e huaj për helenët.

**Fig. – 11** Po ky Ulise ose Odhisea, pse na mban plis?! Historia na ka mësuar se ai është helen?! Jo i dashur lexues. Kur pellazgu e tregonte me rapsodi se ai ishte bir i Itakës epirote me plisin apo me takien e myzeqarit si kësulë në kokë dhe thjesht një ushtar apo luftëtar pellazg në luftën e trojës.<sup>4</sup> Ata që shtrembëruan historinë e bënë hero të tyre, megjithëse nuk e shpjegojnë dot plisin në kokë të tij, të Zeusit të Akilit, të perëndeshës Athinë, etj.

Por, atë e ka mbajtur edhe Pani, (Fig. - 55 ), por e ka mbajtur edhe Akili, por e ka mbajtur dhe e mban ende sot si kësulë Papa i Romës e quajtur ndryshe 'Mitrash', por e ka mbajtur edhe prifti më i lartë hebraik, e cila është krejt ndryshe nga qylafi me ndikim turk.



**Fig. - 12** Akili me kësulën qeleshe, si të labit në kokë kur rrëmbente Kasandrën, sepse ky prijs mirmidon kushëri me odhisen nip në kaoni (Finiq) shqiptar apo pellazg i kohës vertetohet kur udhëheqësi i dardanëve Priami e quan (Akilin) refugjat tek Akejtë, prandaj dhe i thotë: Po ti de skiptron vale ga ie” = Po ti de (pra) shqiptron, vallë nga je? Por, Akili shpjegohet prapë me shqipen, kur mendohet sipas veprave të Homerit se ai ishte njeri i rënë nga qielli, pra: “ai i kiellit” - > “akiel” -> shkurt “akil”. Nëse lexon qartë Iliadën

kupton se Akili është pellazg i migruar nga Thesprotia në Thesali. Por që Akili nuk lidhet me Helenët apo me Grekët, ta jep edhe akademiku M. Sakellariou (Athinë), i cili na thot se emri Akil është paragrek, që grekët e kanë huazuar nga pellazgët.

Që takija e myzeqarit ose plisi i Kosovarit ose guri i bardhë i Tomorit, ruajnë plotësisht autoktoninë e saj në trevën e Myzeqesë dhe të Toskërisë e të Dardanisë, e dëshmojnë edhe gjetjet arkeologjike. Kështu, në Amantia është gjetur një skulpturë, ku paraqitet një i ri me trup atleti i derdhur në bronz, që i përket shek.IV-III p.e.s, i cili mban në kokë një lloj kësule që ka ngjashmëri me takijen e sotme të myzeqarit apo të toskërisë.

**Fig. – 13** Gjetjet arkeologjike në Amantia, ku paraqitet një i ri me trup atleti i derdhur në bronz, që i përket shek.IV-III p.e.s, i cili mban në kokë



<sup>4</sup> H. W. Williams, vizatim i vitit 1819



*një lloj kësule që ka ngjashmëri me takijen e sotme të myzeqarit apo të toskërisë.*

Kemi një tjetër gjetje arkeologjike ne Selcë të Pogradecit, ku paraqitet një artist në bronx me një tip çapare në dorë, por që në kokë ka një kësulë tepër të ngjashme me takijen. Edhe në Apolloni është gjetur një skulpturë e derdhur në bronx që mban në kokë një kësulë të ngjashme me takijen.

**Fig. – 14** Shikoni sesi kësula qeleshe mbahej si nga luftëtari dhe nga harkëtari dhe nga farkëtari dhe nga detari dhe që paqyrohej si në monedha si në vizatime, çka arriti pandërprerë deri në ditët e sotme.

Është kjo arsyeja, që takija quhet “Guri i bardhë” i Myzeqesë, i cili nuk e ka ndarë kurrë nga koka për mijëra vjet dhe e mbante atë si në punë, në gëzim (dasëm, fejesë, etj.) dhe në hidhërim (vdekje apo fatkeqësi të ndryshme).

Ai kurrë nuk e hiqte atë nga koka me përjashtim të rasteve, kur vallëzonte, dhe veçanërisht kur vallja ndizej flak, dhe ai si kryevalltar e merr takijen në dorë, e tundte dhe e

rrotullonte, duke i dhënë valles një element dinamik dhe mjaft piktoresk. Momenti i dytë i “heqjes” së takijes është kur nderon një mik, kur mban një minutë heshtje në nderim të një të vdekuri të zakonshëm apo të rëni për liri, dhe momenti i tretë, kur ekzekutohet Hymni kombëtar, si dhe kur ngrihet Flamuri. Në këto raste, myzeqari e “heq” takijen, e merr me dorën e djathtë dhe se bashku me dorën e vendos në zemër, duke krijuar një kompozim: **dorë - takije - zemër**, që do të thotë sipas shkrimtarit Maksim Zakaj **nderim - paqe - dashuri**.<sup>5</sup> Më gjeni ju të dashur akademik e ju të shkolluar me librat grek e latin rast tjetër të ngjashëm të popujve të tjerë në Ballkan apo në Europë. (fig.89)



<sup>5</sup> Maksim Zarkaj, Shpirti në shekuj, fq 79, Fier, v.2012




**Fig. - 15** Gjetje arkeologjike që na flasin për mbajtje të takies apo plisit apo qeleshes edhe nga sportistë e artistë, çka tregon për popullaritetin e kësaj veshje.

**Fig. - 16** Takija e bardhë e pandarë nga koka e myzeqarit.



Historikisht, njihen tri lloj takije si takija myzeqare në formë konike e zbukuruar me “damarë” (me 10-15 damarë), e cila sipas studiusit M. Zarka, përdoret vetëm në fushë. Tjetër është ajo toske, e cila është një lloj si ajo takija myzeqare, por e zbukuruar me qëndisma. Kjo përdorej si në Myzeqe (kur djali martohej ose në festa fetare apo laike), ashtu dhe në Berat, si dhe ose takija ‘shyte’ me majë në prerë, e cila përdoret në Sulovë kodrinore të Myzeqesë, por që nga suliotët apo çamët e



**Fig. - 17** Takija e bardhë me

Ndërsa, sa i përket bartjes së treva u ndalua nga urrejtja e shoven: “Është interesant se Bujanocit, të Preshevës e të madje edhe të Shkupit nuk

plisa të bardhë shqiptarë, por në viset malore po. Në vend të tyre, gjithnjë e më tepër mbajnë kësula të bëra nga pëlhura e zezë, të qepura e të ngjeshura me penj nga terzinjtë. Trajta e tyre është gjysmë sferike, e ngjashme me plisat e bardhë”.<sup>6</sup>

E gjendur në një situatë presioni politik shtetëror, popullata e trevave në fjalë filloi t’i përshtatet mjedisit në formë mimikërie. “Shkaqet e kësaj dukurie, të braktisjeve të plisave të bardhë në këto vise, duhet kërkuar në mikërinë, në adaptimin, në përshtatjen me rrethin ku jetojnë. Mimikëria u shfaq që nga viti 1912, kur në Maqedoni hyri ushtria okupuese serbe dhe u intensifikua me dhunë në periodën 1915-1917, kur këto vende u okupuan nga ushtria bullgare. Kemi të dhëna se me 1915-1917, autoritetet e atëhershme ua ndalonin shqiptarëve të mbanin plisa të bardhë prej leshi.

takija e Sulovës formë koni të dhe fshatrat origjinën e ka Epirit.

damarë

plisit, ai në disa pushtuesve shqiptarët e Kumanovës, mbajnë më

<sup>6</sup> K. Halimi, vep. cit. fq 151.





**Fig. - 18** Simboli i kokës së dhisë (amalthea) në kaptinë të Zeusit, në monedha, në përkrenare luftëtari ilir (v. 525 para krishtit, fotoja djathtas), duke filluar me Akilin, Aleksandrin e Madh deri te ajo e Skënderbeut, madje edhe në majë të lahutës, e cila luhet nga një malësor me plis në kokë.

Në Prishtinë, më 1922, pushteti lokal u bënte pengesa qeleshe punuesve, ndërsa më 1941 organet e pushtetit okupues bullgar, në Shkup vranë një qeleshe punues vetëm për arsye se refuzoi ta mbyllte dyqanin, nga i cili popullsia furnizohej me plisa të bardhë<sup>7</sup>. Në vitin 1998, Dr. Moikom Zeqo fotografon për herë të parë “Gurin që qëndron në Qiełl” ose “Sofrën e Zotave” në fshatin Vranisht të Vlorës. (fig. 91)

**Fig. - 19** Guri që qëndron në Qiełl ose Sofra e Zotave në fshatin Vranisht të Vlorës, (foto nga Dr. Moikom Zeqo).

Kësisoj, mund të besohet teza e Tor



<sup>7</sup> Po aty, fq.152



Heyerdahl për ekzistencën e një Kulture të tillë në Shqipëri. Shenjat flasin vetë. Idenë për ekzistencën e Kulturës Megalitike në Shqipëri e ka parashtruar edhe vet eksploratori norvegjez Tor Heyerdahl (Udhëtim me Kon-Tikin), gjatë një vizite të bërë në Shqipëri, në fundin e viteve '90, kur shoqërohej nga Dr. Moikom Zeqo. Tor Heyerdahl është i famshëm për ekperimentet që ka kryer për studimin e shpërnguljeve të popujve antikë. I pari që arriti të botojë diçka ishte Profesor Stefanaq Pollo, i cili në vitet '60 botoi për herë të parë se zbuloi një gur që qëndron në këmbë, të cilin ai e quan Menhir (në gjuhën kelte: Menhir = Gur që qëndron në këmbë), në fshatin Limar të Përmetit.



**Fig. - 20** Ilirët, Keltët, Galët<sup>8</sup> Simbolikat e kombit në krahët e veshjeve të shqiptarëve. Këto figura i përkasin të njëjtës periudhë 6000-8000 vite para eres sonë. Vendet ku ndodhen janë qyteti Urit të Irakut, në Rumani, në Kosovë dhe në Vinç, sidomos figurën e identifikuar me ditën e enjte, sepse ka një kurorë në kokë që paraqet rrethin e javës, ku njëherësh qëndron si nuse e

<sup>8</sup> <http://www.facebook.com/photo.php?pid=150594&l=6585e26d9f&id=100001133356751>

*paluar. Nëse i kushtojmë vëmendje kësaj tradite, edhe sot e kësaj dite femrat shqiptare, sidomos nuset e reja palohen në këtë formë që është paraqitur figura e Venerës dhe quhet dita e grave, u bë nuse venuse, është paluar. Ja vetem disa nga objektet që dëshmojnë vazhdimësinë e Plisit (qeleshes), nga pellazgët deri më sot, vetëm tek shqiptarët!*